



# **FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Ekstra 77**

**7 dhjetor**

**2011**

Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Vendim i GJEDNJ  
datë 8.3.2011

Çështja “Eltari kundër Shqipërisë”, ankimi nr.16530/06.....

3

SEKSIONI I KATËRT  
ÇËSHTJA ELTARI KUNDËR SHQIPËRISË  
(ANKIMI NR.16530/06)

**VENDIM**  
(THEMELI)

STRASBURG  
8 mars 2011

Ky vendim gjyqësor do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Eltari kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur si dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, Kryetar,

Lech Garlicki

Ljiljana Mijović

Päivi Hirvelä

Ledi Bianku

Zdravka Kalaydjieva

Nebojša Vučinić, gjykatës

dhe Lawrence Early, protokollues i seancës,

Pasi ka bërë shqyrtimin me dyer të mbyllura më datën 15 shkurt 2011,

jep vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në atë datë:

**PROCEDURA**

1. Çështja ka filluar në bazë të kërkesës (nr.16530/06) kundër Republikës së Shqipërisë, kërkesë e cila është dorëzuar pranë Gjykatës në bazë të nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (Konventa) nga një shtetas shqiptar znj.Zamira Eltari Sharra (kërkuesja) me datën 25 prill 2006.

2. Kërkuesja, së cilës i është dhënë ndihmë ligjore, është përfaqësuar në fillim nga z. F. Braka, i cili u zëvendësua nga z. A. Tartari dhe më pas në vazhdim nga z. S. Puto, të gjithë avokatë, që ushtrojnë profesionin e tyre në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeverisë) është përfaqësuar nga përfaqësuesja e tyre në atë kohë, znj. S. Meneri.

3. Kërkuesja pretendonte se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me padrejtësinë e procedurave të brendshme dhe moszbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Ajo është mbështetur, gjithashtu, edhe në nenin 13 të Konventës dhe në nenin 1 të protokollit 1 të Konventës në lidhje me mungesën e një zgjidhjeje të efektshme për shumën e kompensimit të saj.

4. Më datën 21 nëntor 2006, kryetari i seksionit, të cilit i ishte caktuar çështja, vendosi të njoftojë Qeverinë për kërkesën. Në bazë të dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos që të shqyrtohej themeli i ankimit në të njëjtën kohë me pranimin e saj.

5. Kërkuesja dhe Qeveria paraqitën vërejtje të tjera me shkrim (rregulli 59 § 1).

**FAKTET**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

A. Procedurat lidhur me kthimin e pronës

6. Kërkuesja ka lindur në vitin 1956 dhe jeton në Tiranë.



7. Më datën 28 dhjetor 1994, Komisioni i Vlorës për kthimin dhe kompensimin e pronave (Komisioni) i njohu titullin e pronësisë kërkueses dhe trashëgimtarëve të tjerë për një numër trojesh, ndër të cilat ishte një truall prej 10, 500 m<sup>2</sup>. Meqenëse kthimi i këtij trualli ishte i pamundur, pasi ai ishte i zënë, Komisioni vendosi që kërkuesja dhe trashëgimtarët e tjerë të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji.

8. Më datën 11 shtator 1997, mbështetur në të drejtën e refuzimit fillestar, kërkuesja bëri një kontratë të shitblerjes me zyrën rajonale të Vlorës të agjencisë kombëtare të Privatizimit për blerjen e një farmacie dhe të truallit të saj përkatës 79.5 m<sup>2</sup>, i cili ishte gjoja pjesë e truallit prej 10, 500 m<sup>2</sup>.

9. Farmacisti që kishte farmacinë bëri ankim pranë prokurorisë së Vlorës me pretendimin se kontrata e shitblerjes ishte e paligjshme.

10. Më datën 12 shkurt 1998, prokuroria e Vlorës nisi procedimin civil pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë (Gjykata e Rrethit) duke kërkuar pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes dhe pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit. Farmacisti ndërhyri si palë e tretë.

11. Më datën 15 dhjetor 1999, Gjykata e Rrethit shpalli pavlefshmërinë e pjeshme të vendimit të Komisionit për kthimin e truallit prej 79.5 m<sup>2</sup>, që korrespondonte me truallin e farmacisë. Bazuar në raportin e ekspertit, ajo gjeti se truallit prej 79.5 m<sup>2</sup> kishte qenë shpronësuar në vitin 1920, si rrjedhojë e së cilës, akti i pronësisë, ishte i pazbatueshëm për arsye kohore *ratione temporis*. Pra, kërkuesja nuk mund të kërkonte të drejtë pronësie mbi atë truall në bazë të Aktit të Pronësisë, meqenëse ai nuk ishte shpronësuar nga regjimi komunist. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit vendosi të anulonte kontratën e blerjes së farmacisë, meqenëse një kontratë e tillë bazohej në kushtin që vetëm pronari i truallit kishte të drejtën e refuzimit të parë për ndërtesat e ndërtuara mbi të. Megjithatë, pjesa funksionale e gjykimit shprehej se kërkuesja do të kompensohej vetëm në lidhje me 79.5 m<sup>2</sup>, pasi pjesa e mbetur e së drejtës së pronësisë mbi 10,500 m<sup>2</sup> ishte deklaruar e pavlefshme.

12. Më datën 21 mars 2000, Gjykata e Apelit Ia në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ajo gjeti se prokurori kishte të drejtë *locus standi* të ngrinte padi civile në përpurthje me aktin për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë. Ajo gjithashtu u shpreh se padia civile nuk ishte parashkruar, pasi ajo ishte ngritur në vijim të Aktit të Pronësisë. Ajo gjithashtu hodhi poshtë ankimin e kërkueses lidhur me vlerësimin e provave dhe besueshmërinë e raportit të ekspertit.

13. Më datën 20 mars 2001, Gjykata e Lartë rrëzoi ankimin e kërkueses, si të pabazuar në ligj në bazë të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Më datën 21 maj 2001, kërkuesja bëri një rekurs në interes të ligjit pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

15. Më datën 28 janar 2003, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë rrëzuan rekursin e kërkueses për shkak të pengimit të procedurave të rishikimit që ajo kishte nisur. (Shih “procedura e rishikimit” më poshtë).

16. Në një datë të paspecifikuar, kërkuesja bëri një ankim kushtetues.

17. Me datën 4 nëntor 2005, Gjykata Kushtetuese, mbledhur në sesion plenar, rrëzoi ankimin e kërkueses duke gjetur se nuk kishte pasur asnjë shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese u shpreh se padia civile e prokurorisë ishte mbështetur nga ndërhyrja e farmacistit, i cili kishte interes të plotë në çështje dhe kjo nuk paraqiste ndonjë shkelje të së drejtës së kërkueses për gjykim të drejtë. Gjykata Kushtetuese me tej u shpreh se nuk kishte asnjë provë tjetër imponuese që tregonte se ishte cenuar drejtësia e procedurave.

B. Procedura e rishikimit

18. Në një datë të paspecifikuar, kërkuesja ka kërkuar rishikimin e vendimit të datës 15 dhjetor 1999.

19. Më datën 6 shkurt 2002, Gjykata e Rrethit ka rrezuar kërkesën për rishikim.
20. Më datën 13 maj 2003, pas ankimit të kërkueses, Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e datës 15 dhjetor 1999.
21. Duket se ankimi i kërkueses pranë Gjykatës së Lartë është rrezuar në një datë të paspecifikuar.
- C. Procedurat lidhur me interpretimin e vendimit të datës 15 dhjetor 1999
22. Më datën 12 janar 2005, kërkuësja bëri kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit për interpretimin e vendimit të saj të datës 15 dhjetor 1999, duke argumentuar se ekzistonte një mospërputhje ndërmjet pjesës arsyetuese dhe urdhëruese të vendimit.
23. Më datën 18 shkurt 2005, Gjykata e Rrethit plotësoi kërkesën e saj dhe korrigjoi pjesën urdhëruese të vendimit të datës 15 dhjetor 1999. Ajo konfirmoi se e drejta e pronësisë së kërkueses nuk mund të njihej në raport me 79 m<sup>2</sup> dhe se kërkuësja duhej kompensuar për sa i takon truallit me sipërfaqe 10,500 m<sup>2</sup> në bazë të një prej mënyrave të parashikuara në ligj.
24. Vendimi mori formë të prerë dhe detyruese më datën 7 mars 2005, pasi nuk ishte bërë asnjë apelim kundër tij.
25. Deri sot, autoritetet nuk kanë zbatuar vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 15 dhjetor 1999, i korrigjuar dhe i interpretuar me vendimin e saj të datës 18 shkurt 2005.

## II. LEGJISLACIONI PËRKATËS I BRENDSHËM

### A. Kushtetuta

26. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë shprehin:

Neni 42 § 2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 142 § 3

“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për: ... (f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

### B. Ligji për pronën

27. Legjislacioni përkatës në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronës është përshkruar në vendimet gjyqësore “Gjonbocari e të tjerë kundër Shqipërisë”, nr.10508/02, §§ 36-43, datë 23 tetor 2007, “Driza kundër Shqipërisë”, nr.33771/02, §§ 36-43, datë 13 nëntor 2007, “Ramadhi e të tjerët kundër Shqipërisë”, nr.38222/02, §§ 23-30, datë 13 nëntor 2007.

28. Që nga marrja e këtyre vendimeve gjyqësore janë miratuar masa të reja e thelbësore duke ndryshuar ligjin e pronës të vitit 2004. Ndryshimet kryesore janë si më poshtë vijon:

1. Ligji për pronën i vitit 2005 (ligji nr.9388, datë 4 maj 2005)

29. Neni 3 shtyu afatin kohor deri më 31 dhjetor 2007 për përfundimin e shqyrtimit të kërkesave për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave të paluajtshme, me përjashtimin që pagesa e shumës së kompensimit do të realizohej si afat kohor në vitin 2015.

2. Ligji për pronën i vitit 2006 (ligji nr.9583, datë 17 korrik 2006)

30. Neni 13 krijoi agjencinë e kthimit dhe kompensimit të pronave (Agjencia qendrore), e cila zëvendësoi Komisionin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të pronave (Komisioni Shtetëror). Agjencia qendrore, e cila drejtohet nga një drejtor, e ka zyrën e saj qendrore në Tiranë dhe 12 Zyra Rajonale në qarqe.



31. Sipas nenit 14, zyrat rajonale të agjencisë kanë qenë përgjegjëse për shqyrtimin fillestar të kërkesave për njohjen e të drejtave të pronësisë, në përgjigje të së cilave ajo vendoste rrjedhimisht kthimin dhe/ose kompensimin e pronave. Neni 15 përcakton afatin kohor për dorëzimin e kërkesave për njohjen e të drejtës së pronësisë që ishte 1 tetor 2007.

32. Neni 16 parashikonte që ankimi kundër një vendimi të zyrës rajonale të agjencisë mund të bëhej pranë agjencisë qendrore. Vendimi i agjencisë qendrore mund të ankimohej në Gjykatën e Rrethit Tiranë brenda tridhjetë ditësh nga shpallja e tij.

33. Neni 21 shtyu afatin deri më 31 qershor 2008 për përfundimin e shqyrtimit të kërkesave për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave të paluajtshme, me përjashtim të pagesës së shumës së kompensimit.

34. Neni 22 parashikonte fondin e kompensimit në natyrë (FKN) së bashku me fondin e kompensimit financiar (FKF). Brenda gjashtëdhjetë ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit, Qeveria duhej të miratonte listën e pronave që do t'i kaloheshin FKN-së.

3. Ligji për pronën i vitit 2007 (ligji nr.968, datë 6 shkurt 2007)

35. Neni 1 parashikonte që agjencia qendrore do të ishte përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave për kompensimin në natyrë dhe financiar. Agjencia qendrore do të ishte përgjegjëse edhe për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të zyrave rajonale të agjencisë.

36. Neni 2 theksonte se zyrat rajonale të agjencisë do të vazhdonin të ishin përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave për njohjen e të drejtës së pronësisë. Ankimuesi apo Zyra e Avokatit të Shtetit kishte të drejtë të animonte vendimin brenda tridhjetë ditësh pranë agjencisë qendrore, e cila ishte organi me i lartë administrativ. Një vendim i tillë administrativ ndryshohej nga rishikimi gjyqësor në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

4. Ligji për pronën i vitit 2008 (ligji nr.9898, datë 10 prill 2008)

37. Neni 1 shtyu deri më datën 31 dhjetor 2008 afatin për dorëzimin e kërkesave për njohjen e të drejtës së pronësisë dhe kthimin e pronave nga zyrat rajonale të agjencisë. Ai parashikonte edhe mundësinë që ankimuesve t'u jepej një afat i ri kohor nëpërmjet një vendimi gjyqësor.

38. Në bazë të nenit 2, përfundimi i shqyrtimit të kërkesave për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave do të finalizohet më datën 30 qershor 2009, të paluajtshme, me përjashtimin që pagesa e shumës së kompensimit do të realizohet si afat kohor në vitin 2015.

39. Paragrafi 3 shtyu deri më datën 31 dhjetor 2008 afatin për kalimin e pronave tek fondi i kompensimit në natyrë (FKN).

5. Ligji për pronën i vitit 2009 (ligji nr.10 095, datë 12 mars 2009)

40. Neni 2 parashikonte që përveç alokimeve të buxhetit dhe alokimeve që do të merreshin në bazë të këtij ligji e nga donatorë të tjerë, fondi i kompensimit financiar (FKF) do të përbëhej nga të ardhurat e përfituara nëpërmjet ankandeve të pronave shtetërore, të cilat nuk kishin qenë subjekt i ndonjë vendimi të Komisionit.

6. Ligji për pronën i vitit 2009 (ligji nr.10 207, datë 23 dhjetor 2009)

41. Neni 6 shkriu zyrat rajonale të agjencisë. Ligji përcaktoi se arkivat e këtyre zyrave do të transferoheshin tek Agjencia qendrore. Në bazë të nenit 1, Agjencia qendrore do të përfundonte shqyrtimin e kërkesave për njohjen e të drejtës së pronësisë dhe kthimin e pronave që ishin dorëzuar pranë ish zyrave rajonale të agjencisë. Agjencia qendrore vazhdoi të shqyrtonte ankimet e dorëzuara pranë saj kundër vendimeve të ish Zyrave rajonale të agjencisë.

42. Në bazë të nenit 5, ankimuesi apo Zyra e Avokatit të Shtetit kishte të drejtë të animonte vendimin e Agjencisë qendrore brenda tridhjetë ditësh nga shpallja e tij në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

43. Paragrafi 7 përcaktoi afatin kohor për përfundimin e shqyrtimit të kërkesave për njohjen dhe kthimin e pronave deri më datën 31 dhjetor 2011.

7. Ligji për pronën e vitit 2010 (ligji nr.10 308, datë 22 korrik 2010)

44. Ligji i Pronës i vitit 2010 mundësinë e kërkimit të rishikimit të vendimeve të ish komisioneve/zyrave rajonale të agjencisë.

45. Neni 4 shtyu deri më 31 dhjetor 2011 afatin për kalimin e pronave tek Fondi i kompensimit në Natyrë (FKN).

#### C. Vendimet e Këshillave të Ministrave

1. Vendimet e Këshillit të Ministrave për kompensimet nga fondi i kompensimit financiar (FKF) (nr.13, datë 17 nëntor 2005; VKM nr.758, datë 16 nëntor 2006; VKM nr.566, datë 5 shtator 2007; VKM nr.1343, datë 4 qershor 2008 dhe, VKM nr.487, datë 6 maj 2009)

46. Në bazë të nenit 23 të ligjit të vitit 2004 për pronën, i cili krijoi fondin e kompensimit financiar (FKF), Qeveria miratoi vendimet e mësipërme në periudhën ndërmjet viteve 2005 dhe 2009, në funksion të kompensimit financiar të ish-pronarëve.

47. Në vitin 2005, kompensimi financiar u dha në funksion të kërkesave për kompensim që buronin nga vendimet e Komisionit të Tiranës. Në vitin 2006, kompensimi financiar u dha në funksion të kompensimit të kërkesave që buronin nga vendimet e Komisioneve të Tiranës dhe të Kavajës. Në vitin 2007 grupi i përfituesve u zgjerua për të përfshirë ish-pronarët që zotëronin vendime të Komisionit që ishin dhënë në lidhje me qytetet për të cilat ishte miratuar dhe nxjerrë një hartë vlerë. Në vitin 2008 dhe në vitin 2009 të gjithë ish-pronarët, të cilët gëzonin të drejtën e kompensimit në bazë të një vendimi të komisionit/zyrës rajonale të agjencisë, kualifikoheshin për të aplikuar për kompensim financiar.

48. Në bazë të vendimeve të Këshillit të Ministrave të miratuara në periudhën ndërmjet vitit 2005 dhe 2008, ankimesues iu kërkua të bënte kërkesën standarde për kompensimin financiar pranë Agjencisë qendrore në Tiranë, duke paraqitur, ndër të tjera, vendimin e komisionit/zyrës rajonale të agjencisë që i kishte njohur të drejtën e kompensimit. Vetëm atyre ish-pronarëve që nuk kishin marrë më parë kompensim iu dha e drejta e kompensimit financiar për periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2008. Vendimi i Këshillit të Ministrave i vitit 2009 parashikonte që një ish-pronar do të fitonte të drejtën e kompensimit financiar, me kusht që ai të mos kishte përfituar nga: a) kompensim i mëparshëm; b) restaurim/kthim i pjesshëm prone; c) nga e drejta ndaj refuzimit të parë; d) zbatimi i ligjit për tokën (ligji nr.7501, datë 19 korrik 1991).

49. Kërkesat do të shqyrtoheshin në një rend kronologjik në bazë të datës dhe numrit të vendimit të komisionit/zyrës rajonale të agjencisë. Shuma e kompensimit financiar, e cila duhej llogaritur në bazë të hartave të vlerës së pronës, ishte e kufizuar deri në një maksimum prej 200 m<sup>2</sup>.

50. Dorëzimi i një kërkesë përfshinte pagesën e një tarife për përpunimin e tyre. Ish-pronarët që nuk kishin qenë të suksesshëm në kërkesat e tyre për kompensim financiar në një vit paraardhës, mund të dorëzonin përsëri kërkesën e tyre në vitin/vitet pasardhëse, sapo të kishin paguar tarifën e përpunimit të kërkesës.

51. Asnjë nga këto vendime nuk parashikonte dhënien e kompensimit për ata që kishin pretendime që rridhnin nga një vendim gjyqësor i formës së prerë dhe i detyrueshëm për zbatim.

2. Vendimet e Këshillit të Ministrave për hartat e vlerës së pronave (VKM nr.555, datë 29 shtator 2007; VKM nr.653, datë 29 gusht 2007 dhe VKM nr.139, datë 13 shkurt 2008; dhe VKM nr.1620, datë 26 nëntor 2008)

52. Duke u mbështetur në vendimet e sipërpërmendura, dy prej të cilave u miratuan në vitin 2007 dhe dy në vitin 2008, Qeveria miratoi dhe nxori hartat e vlerës së pronave, siç janë renditur më sipër. Hartat përmbanin çmimin e referencës për metër katror në të gjithë vendin.

53. Vendimi i parë caktonte çmimin e tokës për qarqet Berat, Gjirokastër, Vlorë dhe Dibër; Vendimi i dytë caktonte çmimin e tokës për qarqet Lezhë, Dibër, Korçë dhe Kukës; Vendimi i tretë caktonte çmimin e tokës për qarqet Fier, Elbasan, Tiranë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër. Vendimi i



katërt përmbante një listë çmimesh të përditësuara për disa bashki të caktuara.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave për kompensimin në natyrë të ish-pronarëve (VKM nr.567, datë 5 shtator 2007)

54. Ligji për pronën i vitit 2006 parashikonte krijimin e fondit të kompensimit në natyrë (FKN). Qeveria do të miratonte procedurat për dhënien e pronave që mbuloheshin nga fondi i kompensimit në natyrë (FKN).

55. Me anë të vendimit të datës 5 shtator 2007 Qeveria përcaktoi kriteret dhe procedurat për përcaktimin e pronave shtetërore të mbuluara nga fondi i kompensimit në natyrë (FKN) (VKM nr.567, datë 5 shtator 2007). Neni 1 rendit llojet e pronave, për shembull: a) pronë publike e paluajtshme, e cila ndodhet në zona turistike; b) pronat e Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat nuk përdoren nga forcat e armatosura dhe janë miratuar nga Presidenti i Republikës; c) tokë bujqësore e disponueshme që i përket Ministrisë së Bujqësisë; d) pyjet, kullotat dhe livadhet; dhe e) pronat e institucioneve shtetërore, të cilat dalin jashtë veprimtarisë së synuar të tyre.

56. Agjencia dhe zyrat e saj rajonale janë përgjegjëse për kontrollimin e statusit ligjor të çdo prone që është dorëzuar nga institucioni përkatës shtetëror. Agjencia dorëzon listën përfundimtare të pronave të paluajtshme pranë Ministrit të Drejtësisë për përfshirjen e tyre në fondin e kompensimit në natyrë (FKN). Qeveria duhet të miratojë listën dhe ta botojë atë në Gazetën Zyrtare.

57. Deri tani duket se një listë e tillë nuk është miratuar akoma.

#### D. Kodi i Procedurës Civile

58. Nenet 324-333 rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative pas ezaurimit të të gjitha shkallëve administrative. Neni 324 parashikon që palët mund të ngrenë padi në gjykatë, me qëllim që të revokojnë ose të ndryshojnë një vendim administrativ. Në bazë të nenit 325, paditësi mund të ngrejë padi, kur argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe atij i cenohen interesat e të drejtat e tij drejtpërsëdrejti ose jo drejtpërsëdrejti, në mënyrë individuale ose në mënyrë kolektive.

59. Në lidhje me procedurën e rekursit në Gjykatën e Lartë, Kodi i Procedurës Civile, për aq sa është e përshtatshme, parashikon si më poshtë vijon:

Neni 472

“Vendimet e shpallura nga Gjykata e Apelit, si dhe ato të Gjykatës së Shkallës së Parë, në rastet që parashikohen në këtë Kod, mund të ankimohen me recurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur: (a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji; (b) ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi); (c) nuk është marrë një provë vendimtare e kërkuar nga palët gjatë gjykimit; (ç) janë bërë shkelje procedurale që kanë ndikuar në miratimin e vendimit. ...”

Neni 480

“Rekursi nuk pranohet, në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji. Mospranimi i rekursit vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve”.

#### E DREJTA

##### I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT § 1 TË KONVENTËS

60. Kërkesja është ankuar se procedura e rishikimit gjyqësor lidhur me shpalljen të pavlefshme të kontratës së shitblerjes së datës 11 shtator 1997 ka qenë e padrejtë. Ajo ka pretenduar se autoritetet nuk kishin zbatuar vendimin gjyqësor të datës 15 dhjetor 1999 të Gjykatës së Rrethit, të ndryshuar dhe të interpretuar më datën 18 shkurt 2005.

Neni 6 § 1 i Konventës, për aq sa është e përshtatshme, shprehet:

“Për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile të tij ... çdonjëri ka të drejtën e një procesi të rregull ligjor ... nëpërmjet [a] ... gjykatës ...”

#### **A. Padrejtësia e procedurave lidhur me pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes**

61. Qeveria pretendonte se procedurat e brendshme kanë qenë të drejta. Sipas këndvështrimit të tyre, argumentet e kërkuases ishin trajtuar mirë nga gjykatat e brendshme. Asaj i ishte dhënë mundësia që të dëgjohej përpara gjykatave, të cilat, me radhë, kishin thirrur dëshmitarë dhe kishin urdhëruar për raporte ekspertësh. Qeveria pretendonte se ankesa e kërkuases kishte të bënte me përfundimin e procedurave.

62. Për sa i përket ankesave të kërkuases lidhur me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit të brendshëm, Gjykata përsërit se nuk është në juridiksion të saj të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me atë të gjykatave të brendshme dhe, si rregull i përgjithshëm, duhet që këto gjykata të vlerësojnë provat përpara tyre dhe të interpretojnë të drejtën e brendshme. Detyra e Gjykatës është të konstatojë nëse procedurat në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën sipas së cilës janë marrë provat, kanë qenë të drejta apo jo (shih Jakupi kundër Shqipërisë (vendimi nr.11186/03, datë 1 dhjetor 2009).

63. Gjykata konsideron se, në rastin aktual, kërkuësja është përfaqësuar rregullisht përpara gjykatave të brendshme. Asaj i është dhënë mundësia që të parashtrojë argumentet e saj dhe të mbrojë pikëpamjet e saj. Gjykatat e brendshme, pasi kanë urdhëruar për raporte ekspertësh dhe pasi kanë vlerësuar të gjitha provat, kanë dhënë vendim të arsyetuar dhe kanë rrëzuar ankimin e saj. Gjykata nuk është në gjendje të shohë ndonjë arbitraritet në vendimet e gjykatave të brendshme.

64. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se kjo ankesë në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës është dukshëm e papabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 dhe, për rrjedhojë, është e papranueshme në bazë të nenit 35 § 4 të Konventës.

#### **B. Moszbatimi i vendimit të datës 15 dhjetor 1999, i interpretuar nga vendimi i datës 18 shkurt 2005**

##### *1. Pranimi*

65. Pa u mbështetur në ndonjë rregullim të veçantë, Qeveria pretendoi se kërkuësja nuk kishte përfituar nga të gjitha rregullimet e disponueshme për moszbatimin e pretenduar të vendimit të datës 15 Dhjetor 1999.

66. Kërkuësja është shprehur se ajo kishte konsumuar të gjitha rregullimet e brendshme.

67. Gjykata përsërit se rregulli i ezaurimit të rregullimeve të brendshme të përshkruara në nenin 35 § 1 të Konventës i detyron kërkuësit që të përdorin rregullimet që normalisht janë të disponueshme dhe të mjaftueshme në sistemin e brendshëm ligjor për të përfituar rregullimin e shkeljeve të pretenduara. Ekzistenca e rregullimeve duhet të jetë mjaftueshmërisht e sigurt, në praktikë dhe në teori, mosekzistenca e të cilave çon në mungesën e mundësisë së përdorimit dhe të efektshmërisë së kërkuar të tyre; i takon shtetit përgjegjës që të sigurojë që këto kushte të ndryshme janë përmbushur (shih, më të fundit, Demopoulos dhe të tjerë kundër Turqisë [GC] (Dhjetor), nr.46113/99, 3843/02, 13751/02, 13466/03, 10200/04, 14163/04, 19993/04 dhe 21819/04, §§ 69-70, GJEDNJ 2010-...).

68. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Qeveria nuk është mbështetur në mënyrë eksplicite në një rregullim të veçantë që duhej ezauruar nga kërkuësja. Megjithatë, Gjykata vlerëson se çështja e ekzistencës së rregullimeve të efektshme për sa i përket moszbatimit të vendimit të 15 dhjetor 1999, i interpretuar nga vendimi i datës 18 shkurt 2005, dhe në mënyrë të veçantë, efektshmëria e rregullimeve të ofruara nga ligji për pronën, sidomos ato që janë futur pas miratimit të vendimit





gjyqësor të Gjykatës në çështjen “Driza”, duhen bashkuar themelit dhe shqyrtuar së bashku me ankesën e kërkueses për nenin 13 (shih paragrafët 78-86 me poshtë).

69. Gjykata vlerëson se kërkesa është e bazuar në mënyrë të dukshme në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Gjykata më tej konstaton se ajo nuk gjen bazë tjetër që ta bëjë atë të papranueshme. Prandaj ajo duhet shpallur e pranueshme.

## 2. Themeli

### (a) Parashtrimet e palëve

70. Qeveria tregoi se pjesa urdhëruese e vendimit të datës 15 dhjetor 1999 kishte revokuar të drejtën e pronësisë së kërkueses mbi truallin prej 10,500 m<sup>2</sup>. Rrjedhimisht, kërkuësja nuk kishte interes për zbatimin e vendimit të mësipërm gjyqësor. Vetëm më datën 18 shkurt 2005 Gjykata e Rrethit bëri interpretimin e vendimit të vitit 1999 dhe njohu të drejtën e kërkueses për kompensim në lidhje me truallin në fjalë. Për këtë arsye, Qeveria pretendoi se periudha e moszbatimit, e cila filloi të ecte nga data 18 shkurt 2005, nuk kishte qenë tejet e gjatë.

71. Kërkuësja është shprehur se, deri sot, vendimi i datës 15 dhjetor 1999, i cili njohu të drejtën e saj për kompensim, nuk është zbatuar.

### (b) Vlerësimi i Gjykatës

72. Parimet e përgjithshme në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës lidhur me moszbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatës janë përshkruar në çështjen “Gjyli kundër Shqipërisë”, nr.32907/07, §§ 43-44, 29, datë 29 shtator 2009; dhe “Beshiri e të tjerët kundër Shqipërisë”, nr.7352/03, §§ 60-61, datë 22 gusht 2006.

73. Gjykata vëren se ka ekzistuar një konfuzion fillestar lidhur me zbatimin e vendimit të datës 15 dhjetor 1999, i cili lindi nga mospërputhja ndërmjet arsyetimit të Gjykatës së Rrethit dhe pjesës urdhëruese të vendimit në fjalë. Situata u rregullua në bazë të vendimit të datës 18 shkurt 2005, i cili urdhëroi që të paguhej kompensimi i kërkueses në lidhje me truallin me sipërfaqe 10,500 m<sup>2</sup>.

74. Gjykata vëren me tej se vendimi i datës 18 shkurt 2005 mori formë të prerë dhe detyruese dhe, deri sot, autoritetet nuk kanë marrë masa për të zbatuar këtë vendim në favor të kërkueses. Gjithashtu, Gjykata kujton se ajo ka gjetur tashmë një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë që jepte kompensimin në vend të kthimit në çështjet “Beshiri e të tjerët”, e përmendur më sipër, §§ 62-66; “Driza”, e përmendur më sipër, §§ 87-94; dhe “Vrioni e të tjerët kundër Shqipërisë dhe Italisë”, nr.35720/04 dhe 42832/06, §§ 54-61, 29 shtator 2009. Ajo nuk shikon asnjë arsye të heqë dorë nga këto gjetje në rastin konkret.

75. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin që ka pasur një shkelje të së drejtës së kërkueses për aksesin ndaj gjykatës në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës.

## II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 NË LIDHJE ME NENIN 6 § 1 TË KONVENTËS

76. Kërkuësja është ankuar në bazë të nenit 13 të Konventës se nuk ka pasur ndonjë rregullim në fuqi për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për dhënien e kompensimit në vend të kthimit të pronës.

Neni 13 i Konventës shprehet si më poshtë vijon:

“Çdonjërit që i shkelen të drejtat dhe liritë që janë parashikuar në Konventë përfiton një rregullim të efektshëm përpara një autoriteti kombëtar pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në cilësinë e zyrtarit”.

**A. Pranimi**

77. Gjykata vlerëson se ky ankim është i bazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Gjykata gjen në të se nuk ka asnjë bazë për të qenë i papranueshëm. Prandaj ai duhet shpallur i pranueshëm.

**B. Themeli**

78. Gjykata kujton se në vendimin e saj gjyqësor të çështjes “Driza” ajo ka konstatuar sa më poshtë vijon:

“118. Gjykata vëren se ligji për pronën (i cili u ndryshua nga ligji për pronën i vitit 2004, i cili më pas u ndryshua nga ligji për pronën i vitit 2006) parashikonte forma të ndryshme kompensimi, kur prona origjinale nuk mund t’i kthehej ish-pronarit (...). Ligji për pronën i vitit 1993 ia la përcaktimin e formës së përshtatshme të kompensimit Këshillit të Ministrave, i cili duhej të përcaktonte rregullat e detajuara dhe metodat e zbatueshme për dhënien e kompensimit. Sipas gjetjeve të Gjykatës së Lartë në kuadër të vendimit të saj gjyqësor të datës 7 dhjetor 2000, duheshin organet kompetente për t’u marrë me çështjet e kompensimit (...). Pavarësisht hyrjes në fuqi të ligjit për pronën i vitit 2004, situata nuk ndryshoi. Vetëm me 28 prill 2005 Parlamenti miratoi një ligj që përcaktonte metodologjinë e vlerësimit të pronës për qëllime kompensimi. Paragrafi 5 i atij ligji ia la detyrën e zbatimit të kësaj metodologjie Komisionit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili duhej të kishte nxjerrë planet e përshtatshme të trojeve për të bërë të mundur që të përcaktohej vlera e pronave. Megjithatë, deri sot, këto plane nuk janë miratuar.

119. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se duke mos krijuar organet e përshtatshme që do të merreshin me çështjet e kompensimit apo që do të miratonin planet për vlerësimin e pronave, Qeveria nuk krijoi një procedurë të mjaftueshme në funksion të pretendimeve për kompensim. Gjithashtu, nuk ka gjasa që Qeveria do të krijojë një sistem të tillë së afërmi apo brenda një harku kohor mjaftueshmërisht të shkurtër të aftë të zgjidhë mosmarrëveshjet lidhur me përcaktimin e të drejtave të kërkuarve.”

79. Në rastin e tanishëm, Gjykata vëren se, që nga data e miratimit të vendimit gjyqësor për çështjen “Driza”, Qeveria ka miratuar dispozita të reja ligjore në lidhje me dhënien e kompensimit financiar, miratimin e hartave të caktimit të vlerës së pronës, dhe krijimin e fondit të kompensimit në natyrë (FKN) (shih seksionin “legjislacioni përkatës i brendshëm” më sipër). Prandaj, Gjykata duhet të përcaktojë se nëse masat e miratuara përbëjnë një rregullim të efektshëm apo jo brenda kuptimit të nenit 13 të Konventës.

80. Gjykata përsërit se neni 13 i Konventës jep shprehjen e drejtpërdrejtë të detyrimit të shtetit të sanksionuar në nenin 1 të Konventës për të mbrojtur të drejtat e njeriut së pari brenda sistemit të tyre ligjor. Prandaj, ai kërkon që shteti të sigurojë një rregullim të brendshëm për t’u marrë me thelbin e një “ankimi të diskutueshëm” në bazë të Konventës dhe për të dhënë ndihmën e përshtatshme (Burdov kundër Ruisë (nr.2), nr.33509/04, § 96, GJEDNJ 2009-...; dhe, Yuriy Nikolayevich Ivanov kundër Ukrainës, nr. 40450/04, § 63, GJEDNJ 2009-... (ekstrakte)).

81. Objekti i detyrimeve kontraktuese të shtetit sipas nenit 13 të Konventës ndryshon në vartësi të natyrës së ankimeve të pjesëmarrësve; “efektshmëria” e një “rregullimi” brenda kuptimit të kësaj dispozite nuk varet në sigurinë e një përfundimi të favorshëm për kërkuarësin. Në të njëjtën kohë, rregullimi i kërkuar nga neni 13 duhet të jetë “i efektshëm” në praktikë, si dhe në ligj në kuptimin që ose të parandalojë shkeljen e aluduar apo vazhdimin e saj, ose të ndreqë shkeljen që tashmë është kryer (shih Burdov (nr.2), cituar më sipër, § 97; dhe, Yuriy Nikolayevich Ivanov, cited cituar më sipër, § 64).

82. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në fillim të vendimeve të Qeverisë mbi dhënien e kompensimit financiar, parashikohet në mënyrë eksplicite se kërkuarësi mund të përligjë të drejtën e



tij për kompensim në bazë të vendimit të Komisionit. Dispozitat mbi kompensimin financiar nuk zbatohen ndaj kërkuesve, siç është kërkuesi në rastin konkret, të cilat zotërojnë një titull ekzekutiv kompensimi në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

83. Duke mbajtur parasysh informacionin në zotërimin e saj, gjithashtu vëren se, në praktikë, Agjencia i ka dhënë kompensim vetëm kërkuesve që kanë një vendim të Komisionit. Nuk ka pasur dhënie kompensimesh për pretenduesit që kanë zotëruar një vendim gjykate për zbatim.

84. Për më tepër, Gjykata nuk është në gjendje të identifikojë ndonjë masë tjetër që është miratuar me qëllim që të sigurojë zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për dhënie kompensimi për një kërkues në vend të kthimit të pronës. Qeveria nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të kundërtën.

85. Në referim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka pasur një rregullim të efektshëm që t'i mundësonte asaj zbatimin e të drejtës së saj për kompensim të njohur në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

86. Për këtë arsye, ka pasur një shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë se kërkuesja nuk ka konsumuar të gjitha rregullimet e brendshme në fuqi.

### III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT 1 TË KONVENTËS

87. Kërkuesja ka pretenduar se mospagimi i kompensimit të saj, siç interpretohet në vendimin e datës 18 shkurt 2005, përmbante një shkelje të nenit 1 të protokollit 1, i cili parashikon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të gëzojë i pashqetësuar zotërimet e tij. Askujt nuk mund t'i hiqen zotërimet e tij, përveçse për interesa publike dhe duke iu nënshtuar kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Sidoqoftë, dispozitat procedurale nuk cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e Shtetit për zbatimin e ligjeve të tilla, kur e shoh të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm për të siguruar pagimin e tatimeve apo të kontributeve të tjera ose penalizimeve.”

#### A. Pranimi

88. Gjykata vlerëson se ankimi në bazë të këtij kreu është e bazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Gjykata gjithashtu gjen se nuk janë krijuar baza të tjera për deklarimin e kësaj pjese të kërkesës si të papranueshme, prandaj ajo e deklaron atë të pranueshme.

#### B. Themeli

89. Qeveria parashtroi se e drejta e kërkueses për kompensim është njohur në bazë të vendimit të datës 18 shkurt 2005. Qeveria u mbështet në një dokument i cili përshkruante procesin e kthimit dhe kompensimit të pronës. Sipas dokumentit, procesi i kthimit dhe kompensimit nuk mund të realizohej brenda natës. Vonesat që u krijuan kishin të bënin me procesin e tranzicionit, nëpër të cilin po kalonte vendi. Asnjë vonesë nuk ishte rrjedhojë e neglizhencës apo e mungesës së vullnetit nga ana e shtetit përgjegjës, por e natës komplekse të reformave të ndërmarra në fushën e pronës.

90. Kërkuesja është shprehur se ajo kishte një aset në formën e kompensimit të dhënë nëpërmjet një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Megjithatë, gjatë të gjithë këtyre viteve, ajo nuk ka arritur të ketë zotërimin e këtij aseti për këtë shkak.

91. Gjykata thekson se një “pretendim” mund të përbëjë “një zotërim” brenda kuptimit të nenit 1 të protokollit 1 të Konventës, nëse është përcaktuar mjaftueshmërisht që të jetë i ekzekutueshëm (shih Stran Greek Rafineritë Greke Stran dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, vendimi gjyqësor, datë 9 dhjetor 1994, Seritë A nr.301-B, p. 84, § 59).

92. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Rrethit i datës 15 dhjetor 1999, i interpretuar nga vendimi i datës 18 shkurt 2005, i ka siguruar kërkueses një titull ekzekutiv kompensimi në vend të kthimit të pronës.

93. Gjykata sjell në vëmendje jurisprudencën e saj se pamundësia e një kërkuesi për të realizuar zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë në favor të tij apo të saj përbën një ndërhyrje në të drejtën e gëzimit të pashqetësuar të zotërimeve, siç përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të protokollit 1 (shih, ndër autoritetet e tjera, Burdov kundër Ruisisë, nr.59498/00, § 40, GJEDNJ 2002-III).

94. Gjykata vëren se ajo tashmë ka konstatuar një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për shkak të moszbatimit nga ana e autoriteteve të një vendimi gjyqësor të formës së prerë për dhënie kompensimi (shih paragrafët 72-75 më sipër).

95. Gjykata vëren gjithashtu se ajo ka konstatuar tashmë një shkelje të së drejtës së pronësisë së kërkuesit për shkak të mosdhënies së kompensimit që rrjedh nga një vendim gjyqësor i formës së prerë në çështjet “Beshiri e të tjerët kundër Shqipërisë”, cituar më sipër, §§ 95-103; “Driza”, cituar më sipër, §§ 101-109; dhe “Vrioni e të tjerët kundër Shqipërisë dhe Italisë”, nr.35720/04 dhe 42832/06, §§ 71-77, datë 29 shtator 2009. Gjykata nuk sheh ndonjë arsye tjetër për të arritur në një konkluzion të ndryshëm në rrethanat e rastit konkret.

96. Kështu, ka pasur një shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të Konventës.

#### IV. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

##### A. Neni 46 i Konventës

97. Gjykata vëren se në rastin konkret, ajo ka identifikuar të meta të kuadrit rregullator Shqiptar për sa i përket mungesës së mjeteve për të garantuar zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për dhënien e kompensimit në këmbim të kthimit të pronës. Të meta të tilla duhen trajtuar si një çështje urgjente duke pasur parasysh numrin e personave që ndodhen në situatën e kërkueses dhe objektin për kërkesa të tjera drejtuar Gjykatës që ngrenë të njëjtat çështje (shih Driza, cituar më sipër, § 122).

98. Teksa shteti përgjegjës është i lirë të zgjidhë mjetet me të cilat ai do të përmbushë detyrimet e tij ligjore në bazë të nenit 46 të Konventës, me kusht që mjete të tilla të jenë në përputhje me konkluzionet e përshkruara në vendimin gjyqësor të Gjykatës (shih Burdov kundër Ruisisë) (nr.2), cituar më sipër, § 136), Gjykata vlerëson se kërkohen padyshim masa të përgjithshme në nivel nacional për ekzekutimin e vendimit konkret gjyqësor.

99. Gjykata vëren se problemet në themel të shkeljeve të nenit 6, nenit 13 në lidhje me nenin 6 dhe të nenit 1 të protokollit 1 të Konventës që janë gjetur në këtë rast janë komplekse dhe strukturale. Ato kërkojnë miratimin dhe zbatimin e masave të një karakteri legjislativ dhe administrativ, duke përfshirë autoritete të ndryshme. Gjykata vlerëson se shteti i paditur duhet të marrë masa të mjaftueshme legjislative, administrative dhe financiare për të siguruar dhënien e kompensimit, pa vonesa të paligjshme, të urdhëruar nga një vendim gjyqësor i formës së prerë në vend të kthimit të pronës. Shteti i paditur duhet, për shembull, të caktojë një organ kompetent zbatimi, të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale, të krijojë rregulla procedurale të qarta dhe të thjeshtëzuara për mbledhjen e kërkesave, të përcaktojë afate kohore realiste dhe të detyrueshme për përpunimin dhe zbatimin e tyre, të alokojë fondet e nevojshme buxhetore, dhe të heqë të gjitha pengesat, me qëllim që të sigurojë një dhënie të shpejtë të kompensimit financiar apo në natyrë, duke mbajtur parasysh parimet e vendosura në jurisprudencën e Gjykatës.

100. Gjykata sjell në vëmendje që është shumë e rëndësishme që një vendim gjykate kundër shtetit, që ka marrë fuqinë e gjësë së gjykuar-*res judicata*, duhet zbatuar pa asnjë vonesë të paligjshme. Kërkuesit nuk i duhet kërkuar që të mbajë barrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të gjësë së gjykuar-*res judicata* që janë dhënë në favor të tij kundër shtetit (shih, me ndryshimet e



nevojshme të bëra, “Metaxas kundër Greqisë”, nr.8415/02, § 49, 27 maj 2004). Moszbatimi nga ana e shtetit e vendimeve gjyqësore të gjësë së gjykuar-*res judicata* minon besim publik te sistemi gjyqësor dhe respektin për sundimin e ligjit, i cili është një ndër parimet themelore të shoqërisë demokratike dhe një element i qenësishëm në të gjithë nenet e Konventës (shih, me ndryshimet e nevojshme të bëra, “Stere dhe të tjerët kundër Rumanisë”, nr. 25632/02, § 53, 23 shkurt 2006).

#### B. Neni 41 i Konventës

101. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse Gjykata gjen se ka pasur një shkelje të Konventës apo të protokollit dhe, nëse e drejta ndërkombëtare për Palët e Larta Kontaktuese në fjalë lejon që të bëhet vetëm rregullim i pjesshëm, Gjykata siguron, nëse është e nevojshme, kompensim të drejtë të palës së dëmtuar”.

102. Kërkuesja nuk ka specifikuar një pretendim total në lidhje me dëmin monetar. Ajo ka pretenduar se zotëronte një të njëzetën e pronës dhe kërkoi kompensim për 525 m<sup>2</sup>. Ajo tha se çmimi mesatar i tokës shkonte nga 550 dhe 700 Euro për metër katror, ndërkohë që çmimi i truallit që i përkiste farmacisë ishte ndërmjet 2,500 dhe 3,000 Euro. Ajo kërkoi gjithashtu edhe 100,000 Euro në lidhje me vlerën e ndërtesës së farmacisë. Ajo nuk paraqiti ndonjë pretendim për sa i takon dëmit jomonetar.

103. Qeveria rrëzoi pretendimet e kërkueses.

104. Gjykata vlerëson se çështja e zbatimit të nenit 41 nuk është gati për vendim. Prandaj, çështja duhet rezervuar dhe duhet fiksuar procedura e mëtejshme me kujdesin e duhur ndaj mundësisë së arritjes së marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe kërkueses.

#### PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. I bashkohet themelit të kundërshtimit paraprak të Qeverisë lidhur me moskonsumimin nga ana e kërkueses e rregullimeve të brendshme në funksion të vendimit të datës 15 dhjetor 1999, i interpretuar nga vendimi i datës 18 shkurt 2005;

2. E deklaron ankesën lidhur me padrejtësinë e procedurave sipas nenit 6 § 1 të papranueshme dhe pjesën tjetër të kërkesës së pranueshme;

3. Shprehet se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të 15 dhjetor 1999, i interpretuar nga vendimi i datës 18 shkurt 2005;

4. Shprehet se ka pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës dhe rrjedhimisht rrëzon kundërshtimin paraprak të sipërpërmendur të Qeverisë;

5. Shprehet se ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës;

6. Shprehet se çështja e zbatimit të nenit 41 nuk është gati për vendim;

prandaj:

a) Rezervon çështjen në fjalë në tërësi.

b) Fton Qeverinë dhe kërkuesen që të dorëzojnë, brenda tre muajsh nga data në të cilën vendimi i gjykatës merr formë të prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, vërejtjet e tyre me shkrim për çështjen dhe, në mënyrë të veçantë, të njoftojnë Gjykatën për çdo marrëveshje që ata mund të arrijnë.

c) Rezervon procedurën e mëtejshme dhe i delegon Kryetarit të Dhomës kompetencën që të rregullojë të njëjtën, nëse është nevoja.

Realizuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më datën 8 mars 2011, në zbatim të nenit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

**Lawrence Early**  
Protokollues

**Nicolas Bratza**  
Kryetar

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 5.12.2011  
Doli nga shtypi më 7.12.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 16 lekë